



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE, SHKODËR

Nr. ____ Prot.

Shkoder, me ____ .2026

Relacion

Lënda: Aplikim për "Leje për Ndërhyrje në Pasuri Kulturore Materiale dhe Bonus Rijetësimi - Brenda Kufirit Qendër Historike, Leje për Ndërhyrje në Pasuri Kulturore Materiale dhe Bonus Rijetësimi - Brenda Kufirit Zone e Mbrojtur e Qendrës Historike",
me Numër aplikimi AN170620250010.

Aplikues: BARDHI SHLLAKU

Zhvillues: MANTOVANI - BETON M.B

Vendndodhja: Shkoder, Rruga "Gjuhadol"

Lloji i shërbimit: Aplikim "Brenda Kufirit Qendër Historike", "Brenda Kufirit Zone e Mbrojtur e Qendrës Historike"

Data e inspektimit 03/07/2026

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Aplikimi i bërë në platformën e-albania për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe IKTK me numër AN170620250010, date aplikimit 17.06.2025 dhe date dergimi ne DRTK Shkoder 03.07.2026, ka te beje me nderhyrje ne objektin ekzistues dhe tjetersimin e objektit me funksion hoteleri ne Qendren Historike te Shkodres.

Grafiku i punimeve:

- 30 muaj.

Vlera e preventivit :

- 214,800,135.86 lekë me TVSH

Nga shqyrtimi i projektit të aplikuar si dhe në përputhje me ligjin nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe Vendimin Nr.771 date 30.09.2020 “Per Deklarimin pasuri kulturore të “Qendrës Historike” të qytetit të Shkodrës, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre” u konstatua si më poshtë:

- Objekti ekzistues ka vetëm dy kate dhe projekt propozimi synon ta kthejë objektin në tre, duke tjetërsuar totalisht fasadën e objektit ekzistues.
- Objekti i propozuar nuk është aspak konform ndërtimeve të qendrës historike të qytetit Shkodër, si dhe tjetëron në mënyrë të pariparueshme arkitekturën e ndërtimit aktual vepër e Kolë Idromenos.
- Ndërtimi i ri që propozohet të instalohet në atë ekzistues, prish integritetin ndërtimor dhe estetik të kësaj rruge historike pjesë e qendrës historike të qytetit, duke ndryshuar raportet në vertikalishtet mes ndërtesave si dhe rrit intensitetin e ndërtimit.
- Plotësimi i katit të dytë të ndërtesës në të gjithë gjatësinë e saj, nuk është i justifikueshëm pasi siç shihet edhe në fotot e bashkëngjitura relacionit teknik gjurma në dy pjeset anësore të ndërtesës ekzistuese është pikërisht në lartësinë ku ka qenë çatia e objekteve 1 katëshe, sot pa çatë. Plotësimi i ndërtesës tjetëron karakterin arkitekturor dhe atë estetik të godinës.
- Materialet dhe teknikat e ndërtimit të propozuara në ndërtimin e ri nuk janë konform me ato të miratuara për qendrat historike dhe të mbrojtura, ku vërehet se është përdorur masivisht betoni dhe materiale të tjera.
- Sipas projektit të aplikuar, lartësia e objektit ekzistues deri në kornizën e çatise arrin në 7.63 metra, ndërsa objekti i ri do të arrijë një lartësi maksimale prej 14.75 metra dhe 10.00 metra deri në kornizën e çatise. Kjo lartësi nuk është konform nenit 10 pika 4a për “Kriteret e projektimit për rikonstruksione, ndërhyrjet e lejuara në Qendrën Historike, monumentet e kulturës dhe zonës mbrojtëse të tyre”
- Të sqarohet qëndrimi ndaj objektit ekzistues. Sipas projektit, objekti do të arrijë në kuotën -5.90 metra. Në preventivin e aplikuar nuk kemi punime prishje dhe për këtë arsye kërkojmë sqarim mbi këtë pikë. Nëse nuk kemi punime prishje kërkojmë të saktësohet se si do kryhen punimet e gërmimit pa dëmtuar fasadat e tre objekteve ekzistuese. Kërkojmë informacion se si do lidhen fasadat ekzistuese me objektin e ri.

- Problematike është edhe fakti se në objekt do të realizohen gërmime për realizimin e dy kateve nën tokë. Ndërtimet historike janë shumë të ndjeshme ndaj këtyre lloj gërmimeve që mund të shkaktojnë dëm të pakthyeshme trashëgimisë kulturore materiale.
- Sipas projektit të aplikuar, kati përdhe ka një sipërfaqe prej 840.95 m² (pa oborrin), nga ku 640.55 m² pozicionohen brenda qendrës historike dhe pjesa tjetër brenda zonës mbrojtëse të qendrës historike Shkodër.
- Të përcillet analiza e bërë për të gjithë zërat “AN” sipas preventivit të aplikuar. Të argumentohet pse të gjithë zërat nga manuali i restaurimit janë bërë me analizë.

Fotot e inspektimit



Për DRTK Shkodër :

**Elson Laqja
Fatjon Mlloja
Sabrina Kuçi
Oltion Çuni**

Oltion
Cuni

Digitally signed by
Elson Laqja
Date: 2026.07.03
11:59:12 +02'00'

Fatjon
Mlloja

Digitally signed by
Fatjon Mlloja
Date: 2026.07.03
11:47:31 +02'00'

Drejtör :

Heridon Sokoli

Miratohet :

Petrit Bilali

Pergjegjes sektori AAAMTK